



**RREGULLORE
PËR
REVISTËN SHKENCORE “OPTIME”**

Miratohet
Kryetari i Senatit
Prof. Dr. Kaliopi Naska

Tiranë, më _____. 2021



Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja e Revistës Shkencore “OPTIME”, bazohet në Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në zbatim të tij, në Statutin, Rregulloren e Përgjithshme dhe aktet e brendshme të “Albanian University”.

Neni 2

Objektivat e kësaj Rregulloreje

Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë rregullat kryesore lidhur me procedurat konkrete për shkrimin dhe publikimin e artikujve shkencorë në të.

Neni 3

Emërtimi i Revistës

1. Revista Shkencore e “Albanian University” emërtohet “OPTIME”.
2. Ajo është një revistë shkencore shqiptare me numër regjistrimi ISSN 2220-46 IX.
3. Emërtimi i revistës propozohet nga Bordi Shkencor i saj dhe miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të “Albanian University”.

Neni 4

Qëllimi i Revistës

Revista Shkencore “OPTIME” është një revistë shumë-disiplinore e krijuar me synimin për të shërbyer për zhvillimin kulturor dhe shkencor dhe për të mbledhur energjitetë dhe dinamikat e kërkuesve shkencorë në fushat e shkencave mjekësore, shoqërore dhe atyre inxhinierike e ekonomike.

Neni 5

Organet drejtuese të Revistës

Veprimtaria e organeve drejtuese të Revistës Shkencore “OPTIME”, ushtrohet nga:

Kryeredaktori, i cili është edhe Kryetar i Bordit Shkencor së Revistës “OPTIME”

- Zv.Kryeredaktori, i cili emërohet nga senati dhe ka një mandat 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje;
- **Bordi Shkencor**, i cili është i përbërë nga profesorë të fushave të ndryshme të shkencave mjekësore, shoqërore dhe atyre ekonomike e inxhinierike;
- **Redaktori gjuhësor**;
- **Arti grafik dhe botimi**, kryhet nga “Albanian University Press”.

Neni 6

Bordi Shkencor i Revistës

1. Revista e ushtron veprimtarinë e saj përmes mbledhjeve të Bordit Shkencor, i cili mblidhet të paktën 2 herë në vit, për çdo numër që botohet.
2. Bordit Shkencor është një organ vendimmarrës



3. Anëtarët e Bordit Shkencor duhet të zgjidhen nga radhët e pedagogëve të "Albanian University" dhe institucioneve të tjera bashkëpunuese me tituj dhe grada shkencore, shqiptarë dhe të huaj, me përjashtim të Rektorit i cili është gjithmonë anëtar i tij.
4. Kryeredaktori duhet të jetë me titull, i kategorisë "Profesor" (Bazuar në ligjin për arsimin e lartë 80/2015 neni 6, pika 4)
5. Përbërja e anëtarëve të Bordit Shkencor duhet të përzgjidhet në mënyrë të tillë që të përfaqësohen fushat e shkencave mjekësore, shoqërore dhe atyre inxhinierike e ekonomike.

Neni 7
Kompetencat e Bordit Shkencor

Bordi Shkencor i Revistës ushtron kompetencat e mëposhtme:

- Garanton përmbrushjen e misionit dhe qëllimit shkencor të revistës;
- Mbështet kryeredaktorin dhe ekipin organizativ për të realizuar botimin e revistës.

Anëtarët e Bordit Shkencor të Revistës kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Të bëjnë përpjekje për të grumbulluar dhe porositur materiale dhe artikuj për botim;
- Të lexojnë artikujt dhe të japid mendime mbi cilësinë e tyre;
- Të diskutojnë për artikujt duke caktuar të paktën një recensent për çdo artikull. Në varësi të fushave ku është specializuar secili prej anëtarëve të tij;
- Të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit, duke siguruar jo vetëm pjesëmarrjen, por edhe aktivizimin e plotë në dhënien e mendimeve dhe lexicin e materialeve që do të seleksionohen për botim. Mungesa e pajustifikuar më shumë se në dy mbledhje radhazi sjell zëvendësimin e tyre me një kandidaturë tjetër;
- Të ndihmojnë në rekrutimin e studiuesve të rinj;
- Të shpérndajnë punimet e botuara në revistë me qëllim rritjen e citimeve të tyre.

Neni 8
Kompetencat e organeve të tjera të Revistës

Kryeredaktori:

1. Përcakton udhëzimet e botimit.
2. Krijon periodicitetin dhe/ose nevojën për numra ekstra në varësi të kërkesave për botim. Kryeredaktori është përgjegjës për hartimin e përbajtjes dhe sigurimin që ajo të jetë në përputhje me qëllimin e botimit.
3. Kryeredaktori shqyrton përbajtjen e secilit botim.
4. Përfaqëson botimin si dhe është pjesëmarrës në aktivitet e konferencave të zhvilluara në Albanian University.
5. Është përgjegjës së bashku me Zv. Kryeredaktorin për kontrollin shkencor të revistës.
6. Ka të drejtën, në emër të Bordit Shkencor të kthejë mbrapsht një artikull që nuk e bind në përmbrushjen e kritereve shkencore.
7. Të dërgojë versionin e fundit të faqosur të Revistës për anëtarët e Bordit para se ta botohet.



Zv./Kryeredaktori:

- Të grumbullojë artikujt;
- Të komunikojë me autorët për etapat e botimit të revistës;
- Të kooperojë me kryeredaktorin për të gjitha rastet që ky i fundit e sheh të arsyeshme;
- Të ndihmojë kryeredaktorin në procesin e editimit të numrit;
- Të ndihmojë në procesin e shkëmbimeve midis autorëve dhe kryeredaktorit.
- Të dërgojë kopje elektronike të të gjithë artikujve tek çdo anëtar i Bordit Shkencor të paktën dy javë para mbledhjes së Bordit Shkencor;
- Të mbajë kontakte të rregullta me shtëpinë botuese, përkthyesit, redaktorin gjuhësor, specialistin e faqosjes, etj. duke respektuar rregullat dhe procedurat publike në bashkëpunim edhe me Zyrën e Financave;

Redaktori gjuhësor:

- Të ndjekë zbatimin e formatit sipas udhëzuesit mbi shkrimin e artikujve për revistën "OPTIME";
- Të korrektojë sipas normave standarde të shkrimit të gjuhës shqipe artikujt e revistës
- Të zbatojë çdo porosi të dhënë nga kryeredaktori për qëllime të editimit cilësor të revistës.

Arti grafik :

- Të faqosi dhe të ndjekë procesin nga faqosja deri në momentin e daljes së numrit në shtypje pasi ka marrë kopjen finale nga kryeredaktori apo nga një person i deleguar prej tij.

Neni 9**Përmbajtja dhe struktura e Revistës**

1. Përmbajtja e Revistës duhet të ketë përgjithësish të gjithë elementët e një Reviste Shkencore, si për sa i përket formës, ashtu edhe përbajtjes. Shkrimet duhet të paraqiten si artikuj, jo më shumë se 16 faqe. Një aneks i kësaj Rregullore do të bëjë publik kërkesat teknike që kanë të bëjnë me shkrimin dhe formën e materialeve të dorëzura për botim.
2. Revista duhet të ketë si rregull, strukturën e mëposhtme:
 - Kopertina (Frontespis) Faqja e parë
 - Paraqitja e strukturës organizative të revistës, me të dhënrat përkatëse(Faqja e dytë)
 - Përmbajtja. (Në dy gjuhë në shqip dhe në anglisht)
 - Artikujt Shkencorë që strukturohen sipas Fakulteteve.
3. Në botimin e revistës duhet të synohet që pjesa më e madhe e artikujve të jenë përgatitur nga autorë me tituj e grada shkencore.
4. Çdo artikull apo material duhet të strukturojë qartë: hyrjen ku të shpjegohet qëllimi i temës, përshkrimin/trajtimin e ndarë në nën-çështje sipas problematikës së trajtuar, konkluzionet dhe bibliografinë.
5. Çdo artikull që botohet, nuk duhet të jetë botuar më parë në libër, tekstu, revistë, apo botim tjetër, si dhe nuk duhet të botohet në të ardhmen në ndonjë organ tjetër pa cilësuar botimin për herë të parë në "OPTIME".



Neni 10

Gjuha e botimit të artikujve

Revista shkencore “OPTIME” botohet në gjuhën shqipe dhe angleze me një përbledhje të detyruar në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

Neni 11

Vlerësimi i artikujve dhe aprovimi i tyre.

1. Artikujt e propozuar për tu publikuar në revistën “OPTIME” duhet të vlerësohen me reçensë dhe nga një Anëtar i Bordit (sipas profilit) ose një reçensë nga një anëtar i pavarur, profesionist i fushës përcaktuar nga kryeredaktori ose zëvendësi i tij.
2. Në të gjithë rastet, Bordi Shkencor i publikimit të revistës **duhet t'i përbahet** kësaj rregullore në vlerësimin e artikujve, veçanërisht duhet të vlerësojë në mënyrë rigoroze respektimin e kritereve të përcaktuara në rregullore. Në rast **mos respektimi** të parametrave cilësorë në vlerësimin e artikujve, stafi drejtues i Bordit Shkencor të revistës ka të drejtën të refuzojnë publikimin e tyre.
3. Pas dorëzimit të materialit për botim autorët, nënshkruajnë një deklaratë ku vërtetojnë se punimi është original i autorit/es, dhe se nuk është botuar më parë ose është aktualisht duke u shqyrtuar për botim diku tjetër. Gjithashtu autorët mbajnë përgjegjësi personale nëse konstatohet dukuria e plagiaturës.
4. Autorët e interesuar duhet të dërgojnë draftin elektronik të artikujve të tyre në adresën zyrtare të revistës: optime@albanianuniversity.edu.al. Të gjitha komunikimet midis autorëve dhe bordit shkencor të revistës në lidhje me artikullin, ndryshimet, rishikimet etj., do të bëhen me shkrim përmes e-mailit.

Neni 12

Publikimi i kumtesave të mbajtura në konferanca, kongrese apo simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare

1. Në revistën “OPTIME” mund të publikohen kumtesa të mbajtura në evenimente shkencore si konferanca, kongrese, simpoziume, takime shkencore etj., me karakter shkencor kombëtar ose ndërkombëtar që nuk janë botuar në **Proceedings** të këtyre eveneteve shkencore.
2. Është kusht për publikimin e tyre një kërkesë e Komitetit Organizues të konferencës, kongresit, simpoziumit, përpara zhvillimit të evenimentit, për të pasur mundësinë e publikimit të një grapi të caktuar kumtesash. Kërkesa i dërgohet **Kryeredaktorit** të revistës një muaj përpara realizimit të konferencës. Bordi Shkencor i revistës mund të vërë disa kushte përpara se të akordojë mundësinë e botimit. Këto kushte mund të janë:
 - Publikimi i logos së Revistës dhe i logos së Universitetit AU, në aktet e evenimentit, në të gjitha elementet ku publikohen logot e organizuesve të evenimentit;
 - Rezervimi i një vendi në Komitetin Organizues të Evenimentit në favor të një anëtarit të Bordit të Revistës; ku shpenzimet e të cilit merren përsipër nga organizuesit e evenimentit.
 - Punimi duhet të specifikojë në titull ose në një footnot, emrin e konferencës, se kongresit apo të simpoziumit ku është mbajtur kumtimi, duke specifikuar titullin e saj të plotë.
 - Është e rendësishme, dhe kusht themelor për publikimin e kumtimit, që i interesuarit i paraqesë Kryeredaktorit, me anë të e-mailit, në formë të skanuar, broshurën e



konferencës, kongresit, simpoziumit etj. ku ka marrë pjesë, ku të evidentohet, përveç titullit të takimit, emri i personit dhe titulli i kumtesës së mbajtur.

- Në këtë rregullore sillet një ide e qartë mbi mënyrën e hartimit të artikujve (rregullat formale) për tu publikuar në revistën “OPTIME”. Të gjithë autorët të cilët aspirojnë për të publikuar në këtë revistë janë të lutur t'i ndjekin ato. Të interesuarit të studiojnë me kujdes të gjitha aspektet formale lidhur me shkrimin e saktë të artikullit. Artikujt të cilët do të prezantojnë gabime strukturore-formale nuk do të merren në konsideratë për publikim.

Neni 13

Ruajtja dhe arkivimi revistës “OPTIME”

1. Në çdo botim të revistës “OPTIME” 5 (pesë) kopje depozitohen në Bibliotekën Kombëtare.
2. 3 (tri) kopje depozitohen pranë bibliotekave të Albanian University.
3. Çdo autor/bashkautor merr falas kopjen e tij të revistës.
4. Botimi i artikujve është pa pagesë.
5. Mundësohet shkëmbimi i kopjeve pa pagesë me botues të tjerë kombëtar si Akademia e Shkencave të RSH, etj
6. Shpërndarja dhe rritja e shikueshmërisë së revistës “OPTIME” është përgjegjësi e zyrës së koordinimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike.

Neni 14

Autorësia dhe e drejta e pronësisë

1. Revista “OPTIME” përfaqëson një vepër kolektive të botuar nën drejtimin e “Albanian University” e cila respekton të drejtat morale të shkrimeve.
Pas botimit të shkrimeve dhe artikujve në Revistën “OPTIME”, të drejtën e pronësisë mbi revistën dhe materialet e botuara në numrat e saj e gjzon “Albanian University”. Kjo i jep dhe të drejtën dhe përgjegjësinë e shpërndarjes së saj në formë të shtypur, në internet, në CD-ROM ose në formate të tjera mediatike.
2. Autori i artikullit të miratuar për botim është pronar i së drejtës së autorit në Revistën “OPTIME”.

Neni 15

Financimi i revistës

Revista Shkencore “OPTIME” botohet nga “Albanian University” me fondet e tij, të përcaktuara në Buxhetin vjetor dhe atë afat mesëm 3-vjeçar, sipas zërave që lidhen me kërkimin shkencor dhe botimet akademike.

Bordi Shkencor i Revistës përcakton dhe numrin e Revistave që do të jepen falas.

Neni 16

Vendndodhja

Selia qendrore e Bordit Shkencor të Revistës është në “Albanian University”, Bulevardi Zogu I-rë, Godina ish- Estradës, 1001, Tiranë.

Neni 17



Dispozita të fundit

1. Ndryshimet e Rregullores së Revistë Shkencore “OPTIME” hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin, Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren e Kërkimit Shkencor dhe të Botimeve Akademike të “Albanian University”.
2. Çdo ndryshim i Rregullores së Revistë Shkencore “OPTIME” propozohet nga strukturat përgjegjëse të “Albanian University” dhe miratohet nga Senati Akademik.
3. Universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e kësaj rregulloreje.
4. Senati Akademik ka të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje.
5. Pjesë integrale e kësaj rregullore, janë edhe shtojcat që i bashkëngjiten.
6. Rregullorja miratohet me vendim Nr. ___, datë ____ 2021, dhe hyn në fuqi menjëherë.



ANEKS 1
(*I Regullores së Revistës Shkencore “OPTIME”*)

UDHËZUES MBI ZBATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE TË PARAQITJES SË ARTIKUJVE
SHKENCORË

➤ Vlerësimi i artikujve dhe aprovimi i tyre.

Materialet (artikujt) i adresohen revistës “OPTIME”. Materiali dorëzohet në 3 kopje (një origjinal dhe 2 fotokopje) si dhe **në formën elektronike**. Ai duhet të shoqërohet me adresën e **emailit të autorit** me të cilin do të lidhet Bordi Shkencor në vazhdim. Gjithashtu dorëzohet **një formular**, i cili duhet të firmoset nga autorët e tjerë që i deleojnë autorit kryesor kompetencat. Autorësia nënkupton që secili autor të ketë marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në punim, aq sa të marrë përgjegjësi publike për përbajtjen e tij. Renditja e autorëve përcaktohet nga vendimi i përbashkët i bashkautorëve.

- *Artikujt dërgohen në mënyrë elektronike në adresat e kontaktit optime@albanianuniversity.edu.al.*
- Artikujt i nënshtrohen vlerësimit të Bordit Shkencor, i cili miraton për botim pasi janë bërë modifikimet eventuale nga ana e autorit.
- Materiali i korrigjuar në versionin përfundimtar i dërgohet Kryeredaktorit.
- Pasi kthehet materiali për regullime, ai ridërgohet në formën përfundimtare për tu parë nga ana redaksionale dhe drejtshkrimore të gjuhës shqipe. **Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjes është dhe ç me shkronjat e dhe c.**
- Materiali duhet të renditet sipas kësaj mënyre :

1. Artikujt duhet të prezantojnë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojnë elemente të quartë origjinaliteti. Autori/ja duhet të evidentojë gjithashtu aftësi interpretuese, aftësi kritike, aftësi dogmatike, aftësi rinvuese të mendimit shkencor. Këto parametra përbëjnë kriterin kryesor për vlerësimin e artikujve.
2. Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë e cila duhet të përbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

- 2.1. Marzhet duhet të jenë: **3,5 cm. në krye, 3 cm anash dhe poshtë**.
- 2.2. Artikujt duhet të shkruhen me karakter “Times New Roman” me madhësi karakteri 12. Teksti duhet të jetë justified me **“hapësirë 1”**.
- 2.3. Titulli i artikullit të jetë me shkronjën në **madhësi 14**.
- 2.4. Në abstrakt paraqitet qëllimi, metodat, rezultatet dhe përfundimet.
- 2.5. Pas titullit duhet të vihet emri i autorit (pa kualifikime ose tituj) dhe institucionin ku është kryer puna. Lidhjet e departamenteve ose institucioneve duhet të përcaktohen pas emrit të secilit autor me asterisk *, **, *** etj. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë të saktë dhe të përbledhur.

TITULLI (times new roman 14)

Autor 1*, autor 2**, autor 3***

*Institucioni, Departamenti

**Institucioni 2

***Institucioni 3

Poshtë titullit të artikullit dhe emrit të autorit, të jepet: **Abstrakti** i cili paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht dhe përmban jo më shumë se 250 fjalë.



Abstraktit në anglisht i vihet edhe titulli në të njëjtën gjuhë. Abstrakti duhet të japë detaje të metodave të përdorura dhe gjithashtu gjetjet më të rëndësishme të të dhënavë. Duhet të ketë tituj me shkronja të mëdha / të mëdha për: qëllimin; metodat; rezultatet; statistikat; diskutimi dhe përfundimi.

- 2.6. Poshtë abstraktit shkruhen fjalët çelës. “**Fjalët Çelës:** jo më pak se pesë fjalë.
- 2.7. Hyrja dhe përbajtja e artikullit duke radhitur të gjitha nën çështjet.
- 2.8. Artikulli duhet të jetë i strukturuar gjithmonë me disa nën çështje në varësi të tematikës që shtron. **Çdo artikull duhet të ketë të paktën 10 referenca, vepra dhe artikuj shkencorë.**

3. Materiali

- 3.1 Gjatë shtjellimit të materialit çdo referencë, figurë dhe tabelë numërohet në shifra arabe me numër rendor sipas rendit që citohen në tekst. Kur janë më shumë se 2 referenca ato citohen konform rregullit dhe ndahen me presje në footnote-ën përkatëse.
Nuk përdoren shkurtime të tjera përvèç atyre që janë përdorur në abstrakt.
- 3.2 Falënderimet shtypen në mbarim të tekstit pas referencave.
- 3.3 Grumbullimi i materialeve bëhet mbi bazën e tematikës dhe duhet të orientohet në dy burime: kërkimor shkencor apo përbledhje literature (review).

4. Referencat

Çdo artikull duhet të ketë footnote dhe referenca për çdo material dhe autor të studiuar dhe referuar. Footnote-a duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përbajnjë: autorin, titullin e veprës, vendin (në rast monografie) dhe datën e botimit, faqen nga eshtë marrë citati. Notat duhet të jenë me “spacio 1” dhe teksti të jetë justified. Notat duhet të jenë në kllapa si në tekst ashtu edhe në fund të faqes. P.Sh. GJ. SHKURTAJ, *Shqipja e sotme*, Tiranë: UFO Press, 2010, f. 261. (¹).

Footnote-at duhet të vihen:

- 4.1 Në rast citimi të një monografie emri i autorit me të madhe, titulli i librit me shkronja të vogla - *corsiv* -, qyteti i botimit, viti, faqja. (P.sh. A.DURO, *Termi dhe fjala në Gjuhën shqipe*, Tiranë: Fan Noli, 2009, f. 21. (rast monografie);
- 4.2 Në rast citimi të një artikulli, emri i autorit me të madhe, titulli me shkronja të vogla - *corsiv* -, emri i revistës - në *corsiv* -, numri, viti, (mund të vihet por nuk eshtë e detyrueshme edhe qyteti dhe shteti ku publikohet revista) faqja. P.sh. J. THOMAI, *Studimet në semasiologji-detyrë me rëndësi për gjuhën tonë*, në *Gjuha Jonë*, nr.1, Tiranë: ASHSH, 1988, f. 341.
- 4.4 Në qoftë se janë cituar dy apo më shumë autorë me të njëjtin mbiemër në tekstu, atëherë duhet të shkruhen edhe inicialet e emrit të tij.
- 4.5 Në qoftë se një artikull apo një monografi eshtë cituar më parë, atëherë nuk eshtë më e nevojshme ricitimi komplet, por duhet cituar sipas shembullit që vijon: GJ. SHKURTAJ, *Etnografia e të folurit të shqipes*, cit., f.45 ose GJ. SHKURTAJ, vep. Cit., f. 45. Në qoftë se një autor eshtë cituar dy herë në lidhje me dy vepra të ndryshme, atëherë duhet aplikuar forma e parë e ri-citimit (.GJ. SHKURTAJ, *Kundrime gjuhësore*, cit., f. 55).

(¹) GJ. SHKURTAJ, *Shqipja e sotme*, Tiranë: UFO Press, 2010, f. 261.



- 4.6 Vendimet e gjykatave duhet të sinjalizohen në footnote ku të specifikohet data dhe numri i vendimit. Në qoftë se vendimi është publikuar në një revistë shkencore duhet të citohet edhe emri i saj, viti, numri, faqja e botimit. Emrat e palëve të vendosen me iniciale. Përbajtja e vendimit gjyqësor që është në fuqi mund të analizohet dhe diskutohet, duke dhënë opinione dhe analiza ligjore. Qëndrimi i autorit dhe mendimi i shprehur prej tij mund të jetë i ndryshëm apo i kundërt me atë të dhënë nga vendimi, por ai duhet të jepet nga pikëpamja doktrinore mbi problemin që analizohet dhe jo e lidhur me vendimin. I takon shkruesit/shkrueses të shpjegojë nga ana teorike, sistematike dhe dogmatike elementë pro dhe kundër një mendimi shkencor doktrinor apo një vendimi të një gjykate;
- 4.7 *Për artikujt që janë prezantim rasti klinik* Formati për këto raporte duhet të ndjekë një paraqitje të ngashme me punimet kërkimore. Adresa e fakes së titullit, e autorit duhet të jetë e njëjtë. Duhet të ketë një abstrakt që përshkruan shkurtimisht rastin dhe trajtimin e ofruar. Titujt në abstrakt dhe në tekstu duhet të janë - HISTORIKU për rastin / teknikën klinike duhet të shpjegohet shkurtimisht dhe RAPORTIMI I RASTIT, i cili të përshkruhet në detaje. Duhet të ketë një përshkrim të kujdesit klinik FOLLOW-UP të kryer, i cili duhet të ketë qenë për minimumi dy vjet kur është e përshtatshme, kjo do të tregojë shkallën e suksesit dhe së fundmi duhet të ketë një PËRFUNDIM të shkurtër. Për paraqitjen për raportet e rastit, duhet të merret pëlgimi nga pacienti / kujdestari.
- 4.8 *Provat e origjinalitetit të fotove:* Nëse nuk tregohet ndryshe, provat e galerisë do t'i dërgohen autorit të emrit të parë përmes postës elektronike dhe duhet të kthehen jo më me vonë se 48 orë. Ndryshimet e bëra në provat e galerisë, përvèç korrigjimit të gabimeve të printerit, i ngarkohen autorit. Shifrat dhe fotografitë duhet të janë të një cilësie të mirë për botim dhe për këtë arsy duhet të paraqiten si imazhe jpeg 300 dpi. Shkrimet që nuk i përbahen këtyre udhëzimeve do tu rikthehen për rishqyrtim autorëve

